

**VENDIM NR. 3/3, DATË 06.02.2008 “PËR MIRATIMIN E KODIT ETIK PËR
PUNONJËSIT E ISSH-SË”**

ANEKS 2 “KODI ETIK”

1- QËLLIMI

Qëllimi është që t'i krijohen punonjësve të ISSH-së, lehtësi në punë e tyre, duke vënë theksin tek vlerat e forta etike, parimet dhe rregullat.

2- OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Të gjithë punonjësit e ISSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme, DRSSH-të dhe ALSSH-të, të realizojnë punën e tyre me integritet, objektivitet, paanësi dhe transparencë për vendimet e ISSH.

3- OBJEKTIVA SPECIFIKE

a. Me qëllim që të shmangët konflikti i interesave, punonjësi duhet:

- Të shmangë vullnetarisht, vehten nga situata konflikti, midis interesave të tyre personale, nga njëra anë dhe përmbushjes së menjëhershme të detyrave, detyrimeve e misionit të tyre nga ana tjetër.
- Të heqë dorë nga pasja e një interesi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për kontrata që kanë të bëjnë me ISSH-në. .
- Të bëjë publike faktet ose situatat sensitive që vendosin në konflikt interesin e tyre personal me detyrimet, detyrat dhe misionin e tyre.
- Të qëndrojë larg gjithë situatave që çënon reputacionin e tyre ose të ISSH-së.

b. Me qëllim që të kenë sensin e respektit dhe integritetit, punonjësi duhet:

- Të konsiderojë që përdorimi i informacionit konfidencial, me të cilin është vënë në dijeni gjatë përmbushjes së misionit, për përdorim personal apo për të afërmit, është i padrejtë dhe duhet të përgjigjet për atë.
- Të rrijë larg përsa i përket fakteve dhe informacionit që mund të dëmtojë interesat e ISSH-së ose institucioneve të tjera publike.

- Të tregojë përmbajtje në drejtim të kërkimit, pranimet ose përfitimit të avantazheve, për veten apo të afërmit, në këmbim të marrjes së një pozicioni të caktuar, një ndërhyrje ose një shërbimi.
- Të përmbahet në lidhje me përdorimin ose lejimin e përdorimit të burimeve, mallrave apo shërbimeve, të ISSH-së apo ndonjë institucioni tjetër publik, për qëllim tjetër, të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë përcaktuar, qëllime për të qenë në gjendje pune dhe qëllime administrative.
- Të tregojë përmbajtje në drejtim të përdorimit të autoritetit të pozicionit të tyre për interesa të tyre personale ose interesa të të afërmeve të tyre pavarësisht nga interesat e ISSH-së.

c. Me qëllim që të respektojnë ligjin, punonjësit duhet:

- Të respektojnë dispozitat ligjore dhe administrative që përcaktojnë të drejtat e detyrimit e përfituesve dhe kontribuesve.
- Të veprojnë duke respektuar plotësisht ligjet në fuqi dhe rregulloret e politikave të përshtatura nga ISSH-ja.
- Të respektojnë hirearkinë institucionale si edhe vendimet e marra.

d. Për një menaxhim të rregullt dhe efektiv e për përgjegjësinë e tyre sociale punonjësit duhet:

- Të abstenojnë nga ndonjë koment që ka lidhje me problemet me të cilat përballen ISSH-ja.
- Të angazhohen për t'i shërbyer interesave të institucionit duke përdorur të gjithë aftësitë e tyre.
- Të investojnë për azhurnimin e aftësive dhe njohurive të tyre si edhe të personelit tjetër.
- Të jenë konstruktivë e harmonikë si dhe të mos denigrojnë ose gjykojnë pa arsye kolegët e tyre.
- Të mbështesin kolegët për zhvillimin e aftësive të tyre.
- Të sigurojnë qarkullim të qetë të informacionit mes punonjësve me qëllim lehtësimin e ndërhyrjeve profesionale dhe efektive.
- Të shmangin ngacmimet e çdo forme dhe agresionin verbal në lidhje me kolegët e tyre.

e. Për cilësi të lartë shërbimesh, punonjësit duhet:

- Të respektojnë jetën private të përfituesve dhe kontribuesve.
- Të sigurojnë që diskutimet rreth përfituesve janë bërë në vende të përshtatshme me qëllim shmangien e humbjes së informacionit konfidencial.

- Të japin informacionin e duhur tek personat e autorizuar.
- Të mbajnë me kujdes dhe konfidencialitet dosjet e personelit, përfshirë vlerësimet mjekësore dhe informacionet e tjera personale që kanë të bëjnë me jetën e tyre private.
- Të pranojnë përfituesin me mirësjellje dhe respekt.
- Të intervistojnë klientin duke përdorur emrin e familjes.
- Të komunikojnë duke përdorur fjalë të thjeshta dhe të qarta për t'u siguruar që klienti i kupton.
- Të japin shpjegime për mospranimet, vonesat dhe ankesat që nuk mund të zgjidhen shpejt.
- Të shmangin çdo lloj diskriminimi që bazohet në racë, grupim etnik, gjini, moshë, kombësi, paaftësi, mendim politik, gjuhë, status civil apo social.
- Të mbajë parasysh në mënyrë të vazhdueshme sigurimin e besimit të publikut dhe të veprojë për të ruajtur dhe forcuar kredibilitetin e ISSH-së.

4. DISPOZITAT E FUNDIT

Kodi aktual i etikës duhet t'i bëhet i ditur punonjësve të ISSH-së që nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Dokumenti aktual fillon të zbatohet pasi është miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH-së. Ai mund të ndryshohet dhe përshtatet gradualisht ndryshimeve të organizatës.

Kodi aktual është pjesë integrale e kontratës së punës për çdo punonjës të ISSH-së, i cili është i detyruar ta respektojë atë si dhe të gjithë legjislacioni në fuqi për konfliktin e interesave e për etikën në administratën publike.